

VENDIM
Nr. 248, datë 30.4.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E LLOJEVE TË LICENCAVE/CERTIFIKATAVE DHE
AUTORIZIMEVE, TË DOKUMENTACIONIT TË APLIKIMIT, FORMATEVE TË
KËRKESAVE TË APLIKIMEVE, SI DHE TË FORMATEVE TË LICENCAVE,
AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR TRANSFERIMET
NDËRKOMBËTARE PËR MALLRAT USHTARAKE DHE ARTIKUJT E
TEKNOLOGJITË ME PËRDORIM TË DYFISHTË, QË LËSHOHEN NGA
AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 26, të ligjit nr. 46/2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
**PËRCAKTIMI I LLOJEVE TË LICENCAVE/CERTIFIKATAVE DHE
AUTORIZIMEVE PËR TRANSFERIMET NDËRKOMBËTARE PËR MALLRAT
USHTARAKE DHE ARTIKUJT E TEKNOLOGJITË ME PËRDORIM TË DYFISHTË,
QË LËSHOHEN NGA AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE**

Neni 1

Llojet e licencave dhe certifikatave për transferimet ndërkombëtare për mallrat dhe teknologjitë ushtarake

1. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (në vijim “AKSHE”), në veprimtarinë e mallrave dhe teknologjive ushtarake lëshon elektronikisht me vulë elektronike licencat individuale të mëposhtme:

- a) Licencën e eksportit ose rieksporit;
- b) Licencën për eksport ose import të përkohshëm (panaire/ekspozita/reklama/qëllime testimi/riparime/shërbime mirëmbajtjeje dhe qëllime të tjera të ngjashme);
- c) Licencën e importit;
- ç) Licencën për transit ose transship;
- d) Licencën për veprimtari ndërmjetësuese.

2. AKSHE-ja, në veprimtarinë e mallrave ushtarake, lëshon elektronikisht me vulë elektronike certifikatat e mëposhtme:

- a) Certifikatën e regjistrimit;
- b) Certifikatën ndërkombëtare të importit ose certifikatën e përdoruesit të fundit;
- c) Certifikatën e mbërritjes së mallit në destinacion.

Neni 2

Llojet e licencave dhe të certifikatave për transferimet ndërkombëtare për mallrat me përdorim të dyfishtë

1. AKSHE-ja, në veprimtarinë e mallrave me përdorim të dyfishtë, lëshon elektronikisht me vulë elektronike licencat e mëposhtme:

- a) Licencë individuale ose globale për eksport ose rieksport;

b) Licencë individuale ose globale për eksport ose import të përkohshëm (panaire/ekspozita/reklama/qëllime testimi/riparime/shërbime mirëmbajtjeje dhe qëllime të tjera të ngjashme);

c) Licencë individuale ose globale për import;

ç) Licencë individuale për transit ose transship;

d) Licencë individuale për veprimtari ndërmjetësuese;

dh) Licencë e përgjithshme importi ose eksporti.

2. AKSHE-ja, në veprimtarinë e mallrave me përdorim të dyfishtë, lëshon elektronikisht me vulë elektronike certifikatat e mëposhtme:

a) Certifikatë ndërkombëtare importi për mallra ushtarake ose certifikatë përdoruesi të fundit;

b) Certifikatë e mbërritjes së mallit në destinacion.

Neni 3

Lloji i autorizimit për transferimin ndërkombëtar të mallrave të kontrolluara

AKSHE-ja, në veprimtarinë e mallrave të kontrolluara, lëshon elektronikisht me vulë elektronike autorizimin për negociata për nënshkrimin e një marrëveshjeje/kontrate ekonomike me vendet nën embargo.

KREU II

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR T'U PAJISUR ME LICENCA/CERTIFIKATA PËR TRANSFERIMET NDËRKOMBËTARE PËR MALLRAT DHE TEKNOLOGJITË USHTARAKE

Neni 4

Dokumentacioni i nevojshëm për t'u pajisur me licencë eksporti ose riekspori për mallrat dhe teknologjitë ushtarake

1. Subjekti kërkuar, personi fizik dhe personi juridik privat, i cili kërkon të pajiset me licencë individuale eksporti ose riekspori për mallra ushtarake, paraqet:

a) kërkesën, nëpërmjet portalit “*e-Albania*” për licencë, të plotësuar sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;

b) formular vetëdeklarimi në portalin “*e-Albania*”, që autorizon AKSHE-në për kryerjen e verifikimeve, për:

i. gjendjen gjyqësore (penale dhe civile), lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, ku ka selinë subjekti;

ii. gjendjen e procedimit penal nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, ku ka selinë subjekti;

iii. gjendjen mbi detyrimet përmbartimore ndaj personave fizikë apo juridikë, privatë apo shtetërorë nga Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror;

iv. gjendjen për shlyerjen e detyrimeve nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, ku ka selinë subjekti;

v. licencën e transportit për armët, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Në rast se subjekti nuk e disponon një licencë të tillë, paraqet kontratën me një subjekt të licencuar për transportin e armëve.

c) certifikatën ndërkombëtare të importit ose certifikatën e përdoruesit të fundit;

ç) kopjen e noterizuar të kontratave ndërmjet palëve të përfshira ose urdhërporosinë. Në mungesë të tyre, një prej akteve që konfirmon marrëdhënien ndërmjet palëve, ku janë përcaktuar llojet, sasinë e mallrave dhe çmimet e produkteve, si më poshtë vijon:

i. Fatura e mallit ose proforma;

ii. Komunikimi me *e-mail* ndërmjet palëve.

d) dokumentacionin, që jep të dhëna për përshkrimin e mallit (specifikimet teknike të hartuara nga prodhuesi), si dhe dokumentacionin për të vërtetuar vendin e origjinës e mallit;

dh) dokumentet, që japin të dhëna për subjektin e huaj partner/ndërmjetës, që vërtetojnë të drejtën e këtyre subjekteve për të kryer transferime ndërkombëtare të mallrave ushtarake.

2. Subjekti kërkues, personi juridik publik, i cili kërkon të pajiset me licencë individuale eksporti ose rieksperti për mallra ushtarake:

a) paraqet kërkesën, nëpërmjet portalit “*e-Albania*” për licencë, të plotësuar sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;

b) paraqet dokumentet, që japin të dhëna për subjektin e huaj partner/ndërmjetës, që vërtetojnë të drejtën e këtyre subjekteve për të kryer transferime ndërkombëtare të mallrave ushtarake;

c) paraqet autorizimin për përfaqësuesin e institucionit për ndjekjen e procedurës së licencimit.

Në rastet kur janë institucione shtetërore, një deklaratë për transportin dhe shoqërimin e mallrave ushtarake;

ç) në rastet kur janë ndërmarrje shtetërore, duhet të autorizojë në portalin “*e-Albania*” AKSHE-në për verifikimet mbi licencën e transportit për armët, e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Në rast se subjekti nuk e disponon një licencë të tillë, paraqet kontratën me një subjekt të licencuar për transportin e armëve;

d) paraqet certifikatën ndërkombëtare të importit ose certifikatën e përdoruesit të fundit;

dh) paraqet kopjen e noterizuar të kontratave ndërmjet palëve të përfshira ose urdhërporosinë. Në mungesë të tyre, një prej akteve që konfirmon marrëdhënien ndërmjet palëve, ku janë përcaktuar llojet, sasitë e mallrave dhe çmimet e produkteve, si më poshtë vijon:

i. fatura e mallit ose proforma;

ii. komunikimi me *e-mail* ndërmjet palëve.

e) dokumentacionin që jep të dhëna për përshkrimin e mallit (specifikimet teknike të hartuara nga prodhuesi), si dhe dokumentacionin për të vërtetuar vendin e origjinës e mallit.

3. AKSHE-ja, pas kryerjes së vlerësimit të riskut, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr. 46/2018, kur ka dyshime të arsyetuara, kërkon nga kërkuesi, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, të dhëna shtesë, për:

a) identitetin e palëve të përfshira nga kompanitë vendëse ose të huaja (ortakë, administratorë, përfaqësues ligjorë), si dhe të dhëna për përdoruesin e fundit dhe qëllimin e përdorimit;

b) vendet e transitit, kushtet e transportit, kompanitë transportuese.

Neni 5

Dokumentacioni i nevojshëm për t'u pajisur me licencë për eksport ose import të përkohshëm (panaire/ekspozita/reklama/qëllime testi/riparime/shërbime mirëmbajtjeje, qëllime të tjera të ngjashme)

Subjekti kërkues, i cili kërkon të pajiset me licencë individuale për eksport ose import të përkohshëm për mallra ushtarake:

a) paraqet kërkesën, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, për licencë të plotësuar, sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;

b) paraqet dokumentacionin që jep të dhëna për përshkrimin e mallit (specifikimet teknike të hartuara nga prodhuesi);

c) paraqet deklaratën e firmës partnere të huaj, në rastet e eksportit, ose deklaratën e subjektit importues për përdoruesin e fundit dhe qëllimin e përdorimit të fundit të mallrave, objekt i aplikimit;

ç) paraqet kopjen e noterizuar të kontratave ndërmjet palëve të përfshira ose urdhërporosinë, e në mungesë të tyre, një prej akteve të mëposhtme, që konfirmon marrëdhënien ndërmjet palëve, ku janë përcaktuar llojet, sasitë e mallrave dhe çmimet e produkteve, si:

- i. fatura e mallit ose proforma;
- ii. komunikimi me *e-mail* ndërmjet palëve.

d) personi fizik, personi juridik privat dhe ndërmarrjet shtetërore autorizojnë AKSHE-në në portalin "*e-Albania*" për verifikimet mbi licencën e transportit për armët, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Në rast se subjekti nuk e disponon një licencë të tillë, paraqet kontratën me një subjekt të licencuar për transportin e armëve. Ndërsa, për sa u përket institucioneve qeveritare, ato paraqesin një deklaratë për transportin dhe shoqërimin e mallrave ushtarake.

Neni 6

Dokumentacioni i nevojshëm për t'u pajisur me licencë importi

1. Subjekti kërkuar, personi fizik dhe personi juridik privat, i cili kërkon të pajiset me licencë individuale importi për mallra ushtarake:

a) paraqet kërkesën, nëpërmjet portalit "*e-Albania*", për licencë të plotësuar sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;

b) në formë vetëdeklarimi, në portalin "*e-Albania*", personi fizik dhe personi juridik privat, duhet të autorizojë AKSHE-në për verifikimet, për:

i. gjendjen gjyqësore (penale dhe civile), lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, ku ka selinë subjekti;

ii. gjendjen e procedimit penal nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, ku ka selinë subjekti;

iii. gjendjen mbi detyrimet ndaj personave fizikë apo juridikë, privatë apo shtetërorë nga Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror;

iv. gjendjen për shlyerjen e detyrimeve nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, ku ka selinë subjekti;

v. licencën e transportit për armët, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Në rast se subjekti nuk e disponon një licencë të tillë, paraqet kontratën me një subjekt të licencuar për transportin e armëve.

c) paraqet deklaratën nga subjekti importues për përdoruesin e fundit dhe qëllimin e përdorimit të fundit të mallrave, objekt i aplikimit. Në rastet kur përdoruesi i fundit është i ndryshëm nga importuesi, deklarata për qëllimin e përdorimit duhet bërë dhe nga përdoruesi fundor;

ç) paraqet kopjen e noterizuar të kontratave ndërmjet palëve të përfshira ose urdhërporosinë, e në mungesë të tyre, një prej akteve të mëposhtme, që konfirmon marrëdhënien ndërmjet palëve, ku janë përcaktuar llojet, sasitë e mallrave dhe çmimet e produkteve, si:

- i. fatura e mallit ose proforma;
- ii. komunikimi me *e-mail* ndërmjet palëve.

d) paraqet dokumentacionin që jep të dhëna për përshkrimin e mallit (specifikimet teknike të hartuara nga prodhuesi), si dhe dokumentacionin për të vërtetuar vendin e origjinës të mallit;

dh) paraqet dokumentet, që japin të dhëna për firmën e huaj partnere/ndërmjetës, që vërtetojnë të drejtën e këtyre subjekteve për të kryer transferime ndërkombëtare të mallrave ushtarake.

2. Personi kërkuar juridik publik, i cili kërkon të pajiset me licencë individuale importi për mallra ushtarake, paraqet:

a) kërkesën, nëpërmjet portalit "*e-Albania*", për licencë të plotësuar sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;

b) dokumentet që japin të dhëna për firmën e huaj partnere/ndërmjetës, që vërtetojnë të drejtën e këtyre subjekteve për të kryer transferime ndërkombëtare të mallrave ushtarake;

c) deklaratën nga subjekti importues për përdoruesin e fundit dhe qëllimin e përdorimit të fundit të mallrave, objekt i aplikimit. Në rastet kur përdoruesi i fundit është i ndryshëm nga importuesi, deklarata për qëllimin e përdorimit duhet bërë dhe nga përdoruesi fundor;

ç) autorizimin për përfaqësuesin e institucionit për ndjekjen e procedurës së licencimit;

d) në rastet kur janë ndërmarrje shtetërore, duhet të autorizojnë AKSHE-në në portalin “*e-Albania*” për verifikimet mbi licencën e transportit për armët, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Në rast se subjekti nuk e disponon një licencë të tillë paraqet kontratën me një subjekt të licencuar për transportin e armëve;

dh) në rastet kur janë institucione qeveritare, një deklaratë për transportin dhe shoqërimin e mallrave ushtarake;

d) kopjen e noterizuar të kontratave ndërmjet palëve të përfshira ose urdhërporosinë, e në mungesë të tyre, një prej akteve të mëposhtme, që konfirmon marrëdhënien ndërmjet palëve, ku janë përcaktuar llojet, sasitë e mallrave dhe çmimet e produkteve, si:

i. fatura e mallit ose proforma;

ii. komunikimi me *e-mail* ndërmjet palëve.

ë) dokumentacionin që jep të dhëna për përshkrimin e mallit (specifikimet teknike të hartuara nga prodhuesi), si dhe dokumentacionin për të vërtetuar vendin e origjinës të mallit.

3. AKSHE-ja, pas kryerjes së vlerësimit të riskut, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr. 46/2018, kur ka dyshime të arsyetuara, kërkon nga kërkuesi, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, të dhëna shtesë, për:

a) identitetin e palëve të përfshira nga kompanitë vendëse ose të huaja (ortakë, administrator, përfaqësues ligjor), si dhe të dhëna për përdoruesin e fundit dhe qëllimin e përdorimit;

b) vendet e transitit, kushtet e transportit, kompanitë transportuese.

Neni 7

Dokumentacioni i nevojshëm për t’u pajisur me licencë transiti ose transshipi

1. Subjekti kërkues, i cili kërkon të pajiset me licencë individuale për transit ose transship, paraqet:

a) kërkesën, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, për licencë të plotësuar sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;

b) kopjen e kontratës së shërbimit të transportit;

c) licencën e eksportit ose një dokument tjetër të vlefshëm, lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit eksportues;

ç) licencën e importit ose dokument tjetër të vlefshëm, lëshuar nga autoriteti kompetent i shtetit importues, certifikatën e përdoruesit të fundit ose certifikatën ndërkombëtare të importit;

d) dokumentet, që japin të dhëna për përshkrimin e mallit, dhe vendin e origjinës së mallit;

dh) faturën e mallit dhe listën e paketimit.

2. AKSHE-ja, pas kryerjes së vlerësimit të riskut sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr. 46/2018, kur ka dyshime të arsyetuara, kërkon nga kërkuesi, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, të dhëna shtesë, për:

a) identitetin e palëve të përfshira nga kompanitë vendëse ose të huaja, (ortakë, administratorë, përfaqësues ligjorë), si dhe të dhëna për përdoruesin e fundit dhe qëllimin e përdorimit;

b) vendet e transitit, kushtet e transportit, kompanitë transportuese.

Neni 8

Dokumentacioni i nevojshëm për t’u pajisur me licencë për veprimtari ndërmjetësuese

1. Subjekti kërkues, i cili kërkon të pajiset me licencë individuale për veprimtari ndërmjetësuese:

a) paraqet kërkesën, nëpërmjet portalit “*e-Albania*” për licencë të plotësuar, sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;

b) në formë vetëdeklarimi, në portalin “*e-Albania*”, autorizon AKSHE-në për verifikimet, mbi:

i. gjendjen gjyqësore (penale dhe civile), lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, ku ka selinë subjekti;

ii. gjendjen e mbi detyrimet ndaj personave fizikë apo juridikë, privatë apo shtetërorë, nga Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror;

iii. gjendjen e procedimit penal nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, ku ka selinë subjekti;

iv. gjendjen për shlyerjen e detyrimeve nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, ku ka selinë subjekti.

c) paraqet dokumentacionin për mënyrat e financimit të veprimtarisë (bilanci i vitit të fundit);

ç) paraqet kontratën e nënshkruar të ndërmjetësimit ndërmjet palëve të përfshira;

d) paraqet licencën e eksportit ose një dokument tjetër të vlefshëm, lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit eksportues;

dh) paraqet licencën e importit ose dokument tjetër të vlefshëm, lëshuar nga autoriteti kompetent i shtetit pritës, certifikatën e përdoruesit të fundit ose certifikatën ndërkombëtare të importit;

e) paraqet dokumentet, që japin të dhëna për përshkrimin e mallit (specifikimet teknike nga prodhuesi) dhe dokumentacionin mbi vendin e origjinës së mallit.

2. AKSHE-ja, pas kryerjes së vlerësimit të riskut, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr. 46/2018, kur ka dyshime të arsyetuara, kërkon nga kërkuesi, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, të dhëna shtesë, për:

a) identitetin e palëve të përfshira nga kompanitë vendëse ose të huaja (ortakë, administratorë, përfaqësues ligjorë), si dhe të dhëna për përdoruesin e fundit dhe qëllimin e përdorimit;

b) vendet e transitit, kushtet e transportit, kompanitë transportuese.

Neni 9

Dokumentacioni i nevojshëm për t’u pajisur me certifikatë regjistrimi për mallra ushtarake

1. Subjekti kërkues, personi juridik dhe personi fizik privat, i cili kërkon të pajiset me certifikatë regjistrimi kryen sa më poshtë:

a) paraqet kërkesën, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, për certifikatë të plotësuar sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;

b) në formë vetëdeklarimi, në portalin “*e-Albania*”, autorizon AKSHE-në për verifikimet, mbi:

i. gjendjen gjyqësore (penale dhe civile), lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, në territorin, në kompetencë të së cilës subjekti ka selinë;

ii. gjendjen e procedimit penal nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, në territorin, në kompetencë të së cilës subjekti ka selinë;

iii. gjendjen mbi detyrimet ndaj personave fizikë apo juridikë, privatë apo shtetërorë nga Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror;

iv. gjendjen për shlyerjen e detyrimeve nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, ku ka selinë subjekti.

c) Paraqet strukturën dhe stafin administrativ të shoqërisë;

ç) Paraqet një përmbledhje të shkurtër mbi aktivitetin e deritanishëm, si dhe një argumentim mbi shprehjen e interesit për t’u pajisur me certifikatë regjistrimi;

d) Paraqet dokumente, që vërtetojnë besueshmërinë financiare (bilanci i vitit të fundit);

dh) Personi i autorizuar, administratori ose përfaqësuesi ligjor i tij, në formë vetëdeklarimi, autorizon AKSHE-në në portalin “*e-Albania*” për verifikimet, mbi:

- i. gjendjen gjyqësore (penale), lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, në të cilin personi ka vendbanimin;
 - ii. gjendjen e procedimit penal nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, në të cilin personi ka vendbanimin;
 - iii. gjendjen mbi detyrimet ndaj personave fizikë apo juridikë, privatë apo shtetërorë nga Shërbimi i Përmbaarimit Gjyqësor Shtetëror;
 - iv. gjendjen për shlyerjen e detyrimeve nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, në të cilin personi ka vendbanimin;
 - v. certifikatën e gjendjes gjyqësore.
2. Subjekti kërkuar, personi juridik publik, i cili kërkon të pajiset me certifikatë regjistrimi, paraqet:
- a) kërkesën, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, për certifikatë të plotësuar sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;
 - b) autorizimin me shkrim për përfaqësuesin e institucionit për ndjekjen e procedurës së regjistrimit;
 - c) në rastin e ndërmarrjeve shtetërore, përveç dokumentacionit të personit juridik publik, paraqet:
 - i. vërtetimin, që shoqëria nuk është në proces gjyqësor penal, lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, në të cilin ka selinë shoqëria;
 - ii. vërtetimin që nuk është në procedim penal nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, në të cilin ka selinë shoqëria;
 - iii. vërtetimin nga Shërbimi i Përmbaarimit Gjyqësor Shtetëror, që nuk ka detyrime ndaj personave fizikë apo juridikë, privatë apo shtetërorë;
 - iv. vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, në të cilin shoqëria ka selinë;
 - v. strukturën dhe stafin administrativ të shoqërisë.

Neni 10

Dokumentacioni i nevojshëm për t’u pajisur me certifikatë ndërkombëtare importi dhe certifikatë të përdoruesit të fundit

1. Subjekti kërkuar, i cili kërkon të pajiset me certifikatë ndërkombëtare importi dhe certifikatë të përdoruesit të fundit, paraqet:
 - a) kërkesën, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, për certifikatë të plotësuar sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;
 - b) deklaratën personale të përdoruesit të fundit mbi qëllimin e përdorimit të fundit;
 - c) kopjen e noterizuar të kontratave ndërmjet palëve të përfshira ose urdhërporosinë, e në mungesë të tyre, një prej akteve të mëposhtme, që konfirmon marrëdhënien ndërmjet palëve, ku janë përcaktuar llojet, sasitë e mallrave dhe çmimet e produkteve, si:
 - i. fatura e mallit ose proforma;
 - ii. komunikimi me *e-mail* ndërmjet palëve.
 - ç) dokumentacionin, që jep të dhëna për përshkrimin e mallit (specifikimet teknike të hartuara nga prodhuesi), si dhe dokumentacionin për të vërtetuar vendin e origjinës e mallit;
 - d) dokumentet, që japin të dhëna për firmën e huaj partnere/ndërmjetës, që vërtetojnë të drejtën e këtyre subjekteve për të kryer transferime ndërkombëtare të mallrave ushtarake.
2. AKSHE-ja, pas kryerjes së vlerësimit të riskut, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr. 46/2018, kur ka dyshime të arsyetuara, kërkon nga kërkuar, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, të dhëna shtesë, për:
 - a) identitetin e palëve të përfshira nga kompanitë vendëse ose të huaja (ortakë, administratorë, përfaqësues ligjorë), si dhe të dhëna për përdoruesin e fundit dhe qëllimin e përdorimit;

b) vendet e transitit, kushtet e transportit, kompanitë transportuese.

Neni 11

Dokumentacioni i nevojshëm për t'u pajisur me certifikatën e mbërritjes së mallit në destinacion

Subjekti kërkues, i cili kërkon të pajiset me certifikatë të mbërritjes së mallit në destinacion, paraqet:

- a) kërkesën, nëpërmjet portalit “*e-Albania*” për certifikatë të plotësuar sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;
- b) deklaratën personale të përdoruesit të fundit mbi përdorimin dhe përdoruesin e fundit, vendin, ku malli është magazinuar;
- c) deklaratën doganore mbi importimin e mallit;
- ç) dokumentacionin që jep të dhëna për përshkrimin e mallit (specifikimet teknike të hartuara nga prodhuesi), si dhe dokumentacionin për të vërtetuar vendin e origjinës e mallit.

KREU III

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR T’U PAJISUR ME LICENCA/CERTIFIKATA PËR TRANSFERIMET NDËRKOMBËTARE PËR MALLRAT DHE TEKNOLOGJITË ME PËRDORIM TË DYFISHTË DHE ME AUTORIZIMET PËR MALLRAT E KONTROLLUARA

Neni 12

Dokumentacioni i nevojshëm për t'u pajisur me licencë individuale ose globale eksporti/rieksporti për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë

1. Subjekti kërkues, personi juridik dhe personi fizik privat, i cili kërkon të pajiset me licencë individuale ose globale eksporti/rieksporti për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë, paraqet:

- a) kërkesën, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, për licencë të plotësuar sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;
- b) certifikatën ndërkombëtare të importit/certifikatën e përdoruesit të fundit, e në mungesë të tyre, deklaratën e përdoruesit të fundit mbi qëllimin e përdorimit të fundit;
- c) kopjen e noterizuar të kontratave ndërmjet palëve të përfshira ose urdhërporosinë, e në mungesë të tyre, një prej akteve të mëposhtme, që konfirmon marrëdhënien ndërmjet palëve, ku janë përcaktuar llojet, sasitë e mallrave dhe çmimet e produkteve, si:
 - i. fatura e mallit ose proforma;
 - ii. komunikimi me *e-mail* ndërmjet palëve.
- ç) dokumentacionin, që jep të dhëna për përshkrimin e mallit (specifikimet teknike të hartuara nga prodhuesi), si dhe dokumentacionin për të vërtetuar vendin e origjinës e mallit.

2. Subjekti kërkues, personi juridik publik, i cili kërkon të pajiset me licencë individuale ose globale eksporti/rieksporti për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë, paraqet:

- a) kërkesën, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, për licencë të plotësuar sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;
- b) autorizimin për përfaqësuesin e institucionit për ndjekjen e procedurës së licencimit;
- c) certifikatën ndërkombëtare të importit/certifikatën e përdoruesit të fundit, e në mungesë të tyre, deklaratën e përdoruesit të fundit mbi qëllimin e përdorimit të fundit;
- ç) kopjen e noterizuar të kontratave ndërmjet palëve të përfshira ose urdhërporosinë, e në mungesë të tyre, një prej akteve të mëposhtme, që konfirmon marrëdhënien ndërmjet palëve, ku janë përcaktuar llojet, sasitë e mallrave dhe çmimet e produkteve, si:

- i. fatura e mallit ose proforma;
 - ii. komunikimi me *e-mail* ndërmjet palëve.
 - d) dokumentacionin që jep të dhëna për përshkrimin e mallit (specifikimet teknike të hartuara nga prodhuesi), si dhe dokumentacionin për të vërtetuar vendin e origjinës e mallit.
3. AKSHE-ja, pas kryerjes së vlerësimit të riskut, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr. 46/2018, kur ka dyshime të arsyetuara, kërkon nga kërkuesi, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, të dhëna shtesë, për:
- a) identitetin e palëve të përfshira nga kompanitë vendëse ose të huaja (ortakë, administratorë, përfaqësues ligjorë), si dhe të dhëna për përdoruesin e fundit dhe qëllimin e përdorimit;
 - b) vendet e transitit, kushtet e transportit, kompanitë transportuese.

Neni 13

Dokumentacioni i nevojshëm për t’u pajisur me licencë individuale ose globale për eksport ose import të përkohshëm (panaire/ekspozita/reklama/qëllime testimi/riparime/shërbime mirëmbajtjeje/dhe qëllime të tjera të ngjashme)

1. Subjekti kërkues, personi juridik dhe personi fizik privat, i cili kërkon të pajiset me licencë individuale ose globale për eksport ose import të përkohshëm, paraqet:
 - a) kërkesën, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, për licencë të plotësuar sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;
 - b) deklaratën e firmës partnere të huaj në rastet e eksportit ose deklaratën e subjektit importues, për përdoruesin e fundit dhe qëllimin e përdorimit të fundit të mallrave objekt i aplikimit. Në rastet kur përdoruesi i fundit është i ndryshëm nga importuesi, deklarata për qëllimin e përdorimit duhet bërë dhe nga përdoruesi fundor;
 - c) kopjen e noterizuar të kontratave mes palëve të përfshira ose urdhërporosinë, e në mungesë të tyre, një prej akteve të mëposhtme që konfirmon marrëdhënien ndërmjet palëve ku janë përcaktuar llojet, sasitë e mallrave dhe çmimet e produkteve, si:
 - i. fatura e mallit ose proforma;
 - ii. komunikimi me *e-mail* ndërmjet palëve.
 - ç) dokumentacionin që jep të dhëna për përshkrimin e mallit (specifikimet teknike të hartuara nga prodhuesi), si dhe dokumentacionin për të vërtetuar vendin e origjinës e mallit.
2. Subjekti kërkues, personi juridik publik, i cili kërkon të pajiset me licencë individuale ose globale për eksport ose import të përkohshëm, paraqet:
 - a) kërkesën, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, për licencë të plotësuar sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;
 - b) autorizimin për përfaqësuesin e institucionit për ndjekjen e procedurës së licencimit;
 - c) deklaratën e firmës partnere të huaj, në rastet e eksportit, ose deklaratën e subjektit importues, për përdoruesin e fundit dhe qëllimin e përdorimit të fundit të mallrave objekt i aplikimit. Në rastet kur përdoruesi i fundit është i ndryshëm nga importuesi, deklarata për qëllimin e përdorimit bëhet dhe nga përdoruesi fundor;
 - ç) kopjen e noterizuar të kontratave ndërmjet palëve të përfshira ose urdhërporosinë, e në mungesë të tyre, një prej akteve të mëposhtme që konfirmon marrëdhënien ndërmjet palëve ku janë përcaktuar llojet, sasitë e mallrave dhe çmimet e produkteve, si:
 - i. fatura e mallit ose proforma;
 - ii. komunikimi me *e-mail* ndërmjet palëve.
 - d) dokumentacionin që jep të dhëna për përshkrimin e mallit (specifikimet teknike të hartuara nga prodhuesi), si dhe dokumentacionin për të vërtetuar vendin e origjinës e mallit.
3. AKSHE-ja, pas kryerjes së vlerësimit të riskut sipas kritereve të përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr. 46/2018, kur ka dyshime të arsyetuara, kërkon nga kërkuesi, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, të dhëna shtesë, për:

- a) identitetin e palëve të përfshira nga kompanitë vendëse ose të huaja (ortakë, administratorë, përfaqësues ligjorë), si dhe të dhëna për përdoruesin e fundit dhe qëllimin e përdorimit;
- b) vendet e transitit, kushtet e transportit, kompanitë transportuese.

Neni 14

Dokumentacioni i nevojshëm për t'u pajisur me licencë individuale ose globale për import

1. Subjekti kërkues, personi juridik dhe personi fizik privat, i cili kërkon të pajiset me licencë individuale ose globale import, paraqet:

- a) kërkesën, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, për licencë të plotësuar sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;
- b) deklaratën e subjektit importues, për përdoruesin e fundit dhe qëllimin e përdorimit të fundit të mallrave objekt i aplikimit. Në rastet kur përdoruesi i fundit është i ndryshëm nga importuesi, deklarata për qëllimin e përdorimit bëhet dhe nga përdoruesi fundor;
- c) kopjen e noterizuar të kontratave ndërmjet palëve të përfshira ose urdhërporosinë e, në mungesë të tyre, një prej akteve të mëposhtme që konfirmon marrëdhënien ndërmjet palëve, ku janë përcaktuar llojet, sasitë e mallrave dhe çmimet e produkteve, si:
 - i. fatura e mallit ose proforma;
 - ii. komunikimi me *e-mail* ndërmjet palëve.
- ç) dokumentacionin që jep të dhëna për përshkrimin e mallit (specifikimet teknike të hartuara nga prodhuesi), si dhe dokumentacionin për të vërtetuar vendin e origjinës e mallit.

2. Subjekti kërkues, personi juridik publik, i cili kërkon të pajiset me licencë individuale ose globale për import, paraqet:

- a) kërkesën, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, për licencë të plotësuar sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;
- b) autorizim për përfaqësuesin e institucionit për ndjekjen e procedurës së licencimit;
- c) deklaratën e subjektit importues, për përdoruesin e fundit dhe qëllimin e përdorimit të fundit të mallrave objekt i aplikimit;
- ç) kopjen e noterizuar të kontratave ndërmjet palëve të përfshira ose urdhërporosinë, e në mungesë të tyre, një prej akteve të mëposhtme që konfirmon marrëdhënien ndërmjet palëve, ku janë përcaktuar llojet, sasitë e mallrave dhe çmimet e produkteve, si:
 - i. fatura e mallit ose proforma;
 - ii. komunikimi me *e-mail* ndërmjet palëve.
- d) dokumentacionin, që jep të dhëna për përshkrimin e mallit (specifikimet teknike të hartuara nga prodhuesi), si dhe dokumentacionin për të vërtetuar vendin e origjinës e mallit.

3. AKSHE-ja, pas kryerjes së vlerësimit të riskut, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr. 46/2018, kur ka dyshime të arsyetuara, kërkon nga kërkuesi, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, të dhëna shtesë, për:

- a) identitetin e palëve të përfshira nga kompanitë vendëse ose të huaja, (ortakë, administratorë, përfaqësues ligjorë), si dhe të dhëna për përdoruesin e fundit dhe qëllimin e përdorimit;
- b) vendet e transitit, kushtet e transportit, kompanitë transportuese.

Neni 15

Dokumentacioni i nevojshëm për t'u pajisur me licencë individuale për veprimtari ndërmjetësuese

1. Subjekti kërkues, i cili kërkon të pajiset me licencë individuale për veprimtari ndërmjetësuese, paraqet:

a) kërkesën, nëpërmjet portalit “*e-Albania*” për licencë të plotësuar sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;

b) dokumentacionin mbi mënyrat e financimit të veprimtarisë (bilanci i vitit të fundit);

c) kontratën e nënshkruar të ndërmjetësimit ndërmjet palëve të përfshira;

ç) licencë e eksportit ose një dokument tjetër të vlefshëm, lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit eksportues;

d) licencën e importit ose dokument tjetër të vlefshëm, lëshuar nga autoriteti kompetent i shtetit pritës, certifikatën e përdoruesit të fundit ose certifikatën ndërkombëtare të importit;

dh) dokumentet, që japin të dhëna për përshkrimin e mallit (specifikimet teknike nga prodhuesi), dhe dokumentacionin mbi vendin e origjinës së mallit.

2. AKSHE-ja, pas kryerjes së vlerësimit të riskut, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr. 46/2018, kur ka dyshime të arsyetuara, kërkon nga kërkuesi, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, të dhëna shtesë, për:

a) identitetin e palëve të përfshira nga kompanitë vendëse ose të huaja (ortakë, administratorë, përfaqësues ligjorë), si dhe të dhëna për përdoruesin e fundit dhe qëllimin e përdorimit;

b) vendet e transitit, kushtet e transportit, kompanitë transportuese.

Neni 16

Dokumentacioni i nevojshëm për t'u pajisur me licencë individuale për transit/transship ndërkombëtar për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë

1. Subjekti kërkues, i cili kërkon të pajiset me licencë individuale për transit ose transship, paraqet:

a) kërkesën, nëpërmjet portalit “*e-Albania*” për licencë të plotësuar sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;

b) licencën e eksportit ose një dokument tjetër të vlefshëm, lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit eksportues;

c) licencën e importit ose dokument tjetër të vlefshëm, lëshuar nga autoriteti kompetent i shtetit importues, certifikatën e përdoruesit të fundit ose certifikatën ndërkombëtare të importit;

ç) dokumentet, që japin të dhëna për përshkrimin e mallit dhe vendin e origjinës së mallit;

d) faturën e mallit dhe listën e paketimit.

2. AKSHE-ja, pas kryerjes së vlerësimit të riskut, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr. 46/2018, kur ka dyshime të arsyetuara, kërkon nga kërkuesi, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, të dhëna shtesë, për:

a) identitetin e palëve të përfshira nga kompanitë vendëse ose të huaja (ortakë, administratorë, përfaqësues ligjorë), si dhe të dhëna për përdoruesin e fundit dhe qëllimin e përdorimit;

b) vendet e transitit, kushtet e transportit, kompanitë transportuese.

Neni 17

Licenca e përgjithshme e importit ose e eksportit

1. Licenca e përgjithshme e importit ose eksportit miratohet nga AKSHE-ja për një ose disa kategori të caktuara të mallrave me përdorim të dyfishtë, ku përfshihen disa shtete importuese ose eksportuese dhe përdoret nga të gjithë personat fizikë/juridikë, të cilët veprojnë në përputhje me kërkesat dhe kushtet e parashikuara nga legjislacioni për kontrollin e eksporteve, si dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në licencën e përgjithshme.

2. Licenca e përgjithshme miratohet pas konsultimit me grupet e interesit (operatorët ekonomikë në transferimin e mallrave me përdorim të dyfishtë), me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, si dhe me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

3. Operatorët ekonomikë shprehin interesin për kategoritë e mallrave dhe shtetet, të cilat kërkojnë t'i përfshijnë në licencën e përgjithshme.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave shprehet për kategoritë e mallrave të importuara/të eksportuara, duke dërguar informacion mbi volumin tregtar të tyre.

5. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme shprehet për shtetet, nga të cilat kërkohet lëshimi i licencës së përgjithshme, duke analizuar kriteret e nenit 12, të ligjit nr. 46/2018.

6. AKSHE-ja, në përfundim të procesit të konsultimit, merr vendimin për miratimin ose jo të licencës së përgjithshme, duke përcaktuar kategoritë e mallrave dhe shtetet importuese ose eksportuese.

Neni 18

Dokumentacioni i nevojshëm për t'u pajisur me certifikatë ndërkombëtare importi dhe certifikatë e përdoruesit të fundit për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë (CNI)

1. Subjekti kërkuar, i cili kërkon të pajiset me certifikatë ndërkombëtare importi dhe certifikatë të përdoruesit të fundit, paraqet:

a) kërkesën, nëpërmjet portalit “*e-Albania*” për certifikatë të plotësuar sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;

b) deklaratë personale të përdoruesit të fundit mbi qëllimin e përdorimit të fundit;

c) kopjen e noterizuar të kontratave ndërmjet palëve të përfshira ose urdhërporosinë e, në mungesë të tyre, një prej akteve të mëposhtme që konfirmon marrëdhënien ndërmjet palëve, ku janë përcaktuar llojet, sasitë e mallrave dhe çmimet e produkteve, si:

i. fatura e mallit ose proforma;

ii. komunikimi me *e-mail* ndërmjet palëve.

ç) dokumentacionin, që jep të dhëna për përshkrimin e mallit (specifikimet teknike të hartuara nga prodhuesi), si dhe dokumentacionin për të vërtetuar vendin e origjinës e mallit.

3. AKSHE-ja, pas kryerjes së vlerësimit të riskut, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr. 46/2018, kur ka dyshime të arsyetuara, kërkon nga kërkuar, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, të dhëna shtesë, për:

a) identitetin e palëve të përfshira nga kompanitë vendëse ose të huaja (ortakë, administratorë, përfaqësues ligjorë), si dhe të dhëna për përdoruesin e fundit dhe qëllimin e përdorimit;

b) vendet e transitit, kushtet e transportit, kompanitë transportuese.

Neni 19

Dokumentacioni i nevojshëm për t'u pajisur me certifikatë të mbërritjes së mallit në destinacion për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë

Subjekti kërkuar, i cili kërkon të pajiset me certifikatën e mbërritjes së mallit në destinacion, paraqet:

a) kërkesën, nëpërmjet portalit “*e-Albania*” për certifikatë të plotësuar sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;

b) deklaratën personale të përdoruesit të fundit mbi përdorimin dhe përdoruesin e fundit, vendin ku malli është magazinuar;

c) deklaratën doganore për importimin e mallit;

ç) dokumentacionin që jep të dhëna për përshkrimin e mallit (specifikimet teknike të hartuara nga prodhuesi), si dhe dokumentacionin për të vërtetuar vendin e origjinës e mallit.

Neni 20

Dokumentacioni i nevojshëm për t'u pajisur me autorizim për negociata për nënshkrimin e një marrëveshjeje/kontrate ekonomike me vendet nën embargo

1. Subjekti kërkues, i cili kërkon të pajiset me autorizim për negociata për nënshkrimin e një marrëveshjeje/kontrate ekonomike me vendet nën embargo, paraqet:

a) kërkesën, nëpërmjet portalit “*e-Albania*” për autorizim sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;

b) kopje e draftmarrëveshjes ose të kontratës, që do të negociohet, ku janë përcaktuar përdoruesit e fundit dhe mallrat.

2. AKSHE-ja, pas kryerjes së vlerësimit të riskut, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr. 46/2018, kur ka dyshime të arsyetuara, kërkon nga kërkuesi, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, të dhëna shtesë, për:

a) identitetin e palëve të përfshira nga kompanitë vendëse ose të huaja (ortakë, administratorë, përfaqësues ligjorë), si dhe të dhëna për përdoruesin e fundit dhe qëllimin e përdorimit;

b) vendet e transitit, kushtet e transportit, kompanitë transportuese.

3. AKSHE-ja, për verifikimin e të dhënave në dokumentacionin e mësipërm, bashkëpunon me institucionet e tjera të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara, sipas përcaktimeve të kreut III, të vendimit nr. 31, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin, përbërjen, funksionimin dhe statusin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe të procedurës për shkëmbimin e informacionit dhe të marrjes së mendimit nga institucionet e tjera të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara, si dhe përcaktimin e procedurave për lëshimin e garancive dhe kryerjen e kontrollit shtetëror”, në rastet kur këto negociata janë objekt i fushës së përgjegjësisë së këtyre institucioneve.

KREU IV

DISPOZITA PROCEDURALE DHE FORMATET E KËRKESAVE TË APLIKIMEVE, SI DHE FORMATET E LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE

Neni 21

Dispozita procedurale

1. Dokumentacioni për individët, personat fizikë dhe juridikë, i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, verifikohet nga AKSHE-ja nëpërmjet ndërveprimit institucional dhe konsiderohet i vlefshëm dhe origjinal në dosjen e aplikimit.

2. AKSHE-ja, nëpërmjet ndërveprimit institucional, siguron:

a) me autorizim të subjektit kërkues, dokumentacionin, si më poshtë vijon:

i. Vërtetimin mbi gjendjen gjyqësore (penale dhe civile), lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, në të cilin shoqëria ka selinë;

ii. Vërtetimin nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, në të cilin shoqëria ka selinë, mbi gjendjen e procedimit penal;

iii. Vërtetim nga Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror mbi detyrimet ndaj personave fizikë apo juridikë, privatë apo shtetërorë;

iv. Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve në të cilin shoqëria ka selinë për shlyerjen e detyrimeve;

v. Licencën e transportit për armët, e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;

vi. Licencën e tregimit për mallrat ushtarake, e lëshuar nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes.

b) me autorizim të administratorit/përfaqësuesit ligjor të subjektit kërkues dokumentacionin, si më poshtë:

- i. Vërtetimin mbi gjendjen gjyqësore (penale), lëshuar nga gjykata e rrethit gjyqësor, në të cilin personi ka vendbanimin;
 - ii. Vërtetimin nga prokuroria e rrethit gjyqësor, në të cilin personi ka vendbanimin, mbi gjendjen e procedimit penal;
 - iii. Vërtetimin nga Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror, mbi detyrimet ndaj personave fizikë apo juridikë, privatë apo shtetërorë;
 - iv. Vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, në të cilin personi ka vendbanimin;
 - v. Certifikatën e gjendjes gjyqësore.
3. Subjekti i huaj/individ i vërteton se ai i plotëson të gjitha kërkesat e renditura në pikën 2 të këtij neni. Nëse dokumentet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë ai sjell dokumente analoge ose formulon një deklaratë me shkrim.
4. Në aplikimet për mallrat ushtarake, dokumentet zyrtare në gjuhë të huaj duhet të jenë të legalizuara ose me vulën apostile dhe shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.
5. Aplikimet për licencat/certifikatat dhe autorizimet e përcaktuara në kreun I të këtij vendimi, shoqërohen me mandatpagesën e tarifës përkatëse, caktuar me vendimin e Këshillit të Ministrave, të nxjerrë në zbatim të pikës 1 të nenit 46, të ligjit nr. 46/2018, "Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë", të ndryshuar.

Neni 22

Formatet e kërkesave të aplikimit

Formatet e kërkesave të aplikimit, që paraqesin subjektet e përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, për pajisjen me dokumente ligjore, janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 23

Formatet për licencat/autorizimet/certifikatat

Formatet për licencat/autorizimet dhe certifikatat e lëshuara nga AKSHE-ja janë sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 24

Dispozita të fundit dhe kalimtare

1. Rregullat mbi kërkesat dhe procedurat administrative, që preken prej tij, zbatohen pasi të përfundojnë zhvillimet teknike për pritjen e trajtimin e aplikimeve në sistemin e përmirësuar të menaxhimit të informacionit për AKSHE-në.
2. Ngarkohet Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja nr. 1

**FORMATET E KËRKESAVE PËR APLIKIM PËR
LICENCAT/AUTORIZIMET/CERTIFIKATAT PËR MALLRAT USHTARAKE**

1. Licencë eksporti ose riekporti.
